

ENKELEJDA ALITE

NIPT L01606037A

Adresa: Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane

Mob. +355 (0)67 2005022

e-mail: enkealite@yahoo.com;

Tiranë, më 19.02.2024

Lënda: Informacion në lidhje me auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendim nr.825, date 13.12.2023 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) , datë 13.12.2023, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, ne kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me poste të letres me kthim përgjigje, në adresën e selisë së partisë.

Sipas letrës bashkangjitur Z.Ymer Kurti, kryetari i partisë ka firmosur zarfin në të cilin është informuar në lidhje me kërkesën për fillimin e procedurave të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara të fushatës të datës 14 Maj 2023.

Gjithashtu më datë 08.02.2024 është dërguar edhe një email në adresën zyrtare të partisë: pmdealbania@hotmail.com dhe cc.enxhi.podgorica@kqz.gov.al në të cilën është kërkuar takim me Z.Ymer Kurti për të na vënë në dispozicion informacionin për fillimin e procesit të auditimit.

Për këtë Parti u përdorën komunikimet që na u vunë në dispozicion nga KQZ si adresë selie, adresë emaili, informacione nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si edhe kërkime në internet, por të gjitha mënyrat e përdorura nuk sollën rezultat.

Ne kërkuam edhe në faqen zyrtare të KQZ-së për raportimin financiar të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023 të subjekteve zgjedhore por nuk gjetëm ndonjë raport në lidhje me Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve.

Gjithashtu edhe nga raportet e monitorimit nuk rezultoi ndonjë gjetje.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues:


Letra e dërguar me postë me konfirmimin e shërbimit postar dhe kthimin e pergjigjes me firmën e vetë kryetarit të Partisë për vënien në dijeni të procesit të auditimit të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023.

E-maili i dërguar ne adresën e partisë :pmdealbania@hotmail.com

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Me respekt,

Enkelejda Alite
Auditues Ligjor



ENKELEJDA ALITE
AUDITUES LIGJOR
Licensa Nr.309, Date 28.03.2014
Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane
Mob. +355 (0)67 2005022
e-mail:enkealite@yahoo.com

Tiranë, më 30.01.2024

Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor.

Për: Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Emigranteve
Drejtuar kryetarit: Z. Ymer Kurti
Adresa e selisë: Lagjja Ali Demi,Rr.C.Curre,shk.1, Ap.18, Pall.Boga,Tirane

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.825,datë 13.12.2023 , jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Emigranteve për zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 14 Maj 2023.

Sipas kontratës nr. 220 prot. datë 23.01.2024, me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 14 maj 2023 në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra ne zbatim te tij ne lidhje me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjate vitit kalendarik pararendes, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre". Afati i përfundimit të procesit te auditimit eshte data 23.02.2024.*


Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na berë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

Enkelejda Alite
Auditues Ligjor



1. PËR T'U PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMËRIMIT

Objekti Nr. datë..... Lekë

Është pranuar në zyrën në drejtim të zotit
PARTIA PËR DIBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË EMIGRANTËVE
LOJZE ALI DRENI RUC Ce ne, sh. 18
R. e B. 10 GA, TIRANA

2. PËR T'U PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është Dorëzuar më datën

Paguar Besim

Emri mbiemri Emri mbiemri
i marrësit të objektit i shpërndarësit

SHËNIME TË VEÇANTA

Vula datare e Zyrës
Dorëzuese të objektit

(Personi vlek)



POSTA SHQIPTARE sh.a.
Zyra Postare



LAJMËRIM MA



RR 563 775 156 AA 601

Ky lajmërim - marrje do të kthehet
në adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi
Mod P6

Z.N. ENJELEJAN ALIJE
Rr. Abdi Topfani
Tona Duku Kati D
Zyra 18, Tirane

110201

Sent Search in sent... Advanced

Home

Compose

Back Archive Move Delete Spam



- Inbox
- Unread
- Starred
- Drafts 561
- Sent**
- Archive
- Spam
- Trash
- Less
- Views Hide
- Photos
- Documents
- Emails to myself
- Subscriptions
- Receipts
- Credits
- Travel
- Folders Hide
- + New Folder
- Draf
- Junk
- Notes

RE: Auditimi i fondeve te fushates zgjdhore te dates 14 maj 2023 te subjektit zgjedhor "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Emigranteve" Enkelejda Al.../Sent ☆



Enkelejda Alite Thu, Feb 8 at 2:13 PM ☆
From: enkealite@yahoo.com
To: pmdealbania@hotmail.com
Cc: Enxhi Podgorica

Pershendetje Z.Kurti,

Une jam Enkelejda Alite, Audituese Ligjore, e caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeje per te bere auditimin e fondeve te fushates se dates 14 maj 2023 te subjektit tuaj zgjedhor.

Me date 31 Janar 2024 ju kam derguar me poste me kthim pergjigje nje kerkese per fillimin e procedurave te auditimit. Ju e keni marre shkresen time dhe e keni firmosur.

Ju lutem duhet te kontaktojme sa me shpejt te jete e mundur per te kryer auditimin e fondeve te fushates 14 maj 2023 brenda afatave qe parashikon kontrata e lidhur me KQZ-ne. Afati i fundit eshte date 23 Shkurt 2024.

Bashkangjitur po ju dergoj perseri kerkesen time dhe kontraten me KQZ-se per te cilen une jam angazhuar per te kryer sherbimin e auditimit te fondeve te fushates te dates 14 maj 2023.

Me respekt,

Enkelejda Alite
 Legal Auditor
 St.Abdi Toptani,TorreDrin,Floor0,OfficeNo.19, Tirana,Albania
 Mob.:+3550672005022E-mail:enkealite@yahoo.com
 Download all attachments as a zip file